



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICIONIN

“Mjek/e”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “**Ekipe Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Mjek/e**”.

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjeçar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Mjekut/es

Jemi në kërkim të një mjeku/e të përgjithshëm, i/e cili/a do të merret me protokollat për të siguruar shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve dhe studentëve të prekur nga projekti, duke shërbyer si një konsulent mjekësor, që miraton protokollat mjekësore, procedurat e urgjencës si dhe protokollat për procedurat e monitorimit dhe matjeve të nxënësve sipas sporteve përkatës. Mjeku do të jetë përgjegjës dhe për trajnimin e trajnerëve për të zbatuar protokollat e matjeve si dhe do të analizojë të dhënat e dërguara nga terreni, duke vlerësuar shëndetin e nxënësve. Këto të dhëna do të monitorohen dhe do të dokumentohen për të nxjerrë përfundime dhe analiza në nivel makro. Ky person raporton tek Drejtori i Projektit. Për të përmbushur objektivat e caktuara Mjeku/ja duhet të ketë:



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Universiteti i Mjekësisë -Me ose pa Eksperience;
- Eksperienca e mëparshme në mjekësi sportive përbën avantazh;
- Aftësi ne punen me kompjuter (Microsoft Office në nivel shumë të mirë);
- Eshte i/e pergjegjshme dhe I/e perkushtuar;
- Veteinicies dhe i/e gatshme per angazhim shtese;
- Ka aftesi te shkelqyera komunikimi me pacientin.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 12 Maj 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Mjek/e "Ekipet Sportive 2022"**

